



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TATIMPAGUESVE  
Sektori i Asistencës dhe Shërbimit për Tatimpaguesit

Nr.10593/4 Prot.

Tiranë, më 23.05.2017

**Drejtuar: Z.Filip Çakuli**

Drejtor

Redaksia e emisionit "Fiks Fare"

Televizioni Top Channel

Adresa: "17 Nëntori" Godina nr.20 Mëzez Kodër, Kashar

TIRANË

**Lënda: Kthim përgjigje**

I nderuar z. Çakuli,

Në përgjigje të kërkesës tuaj nr.377 Prot., datë 11.05.2017, protokolluar në DPT me nr. 10593 datë 11.05.2017, me lëndë "Kërkesë për informacion", bazuar në ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e Informimit", regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 23, në të cilën kërkohet:

1. Informacion lidhur me emërimet e kryera tre muajt e fundit pranë institucionit tonë, duke përfshirë këtu edhe emërimet me kontratë të përkohshme

pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", ju sqarohet si më poshtë vijon:

Me Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit është miratuar struktura organizative e Administratës Tatimore Qendrore, e cila ka në total 1569 pozicione pune, nga të cilët 1165 janë pozicione të cilat trajtohen me dispozitat e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe 404 pozicione të cilat trajtohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

Në fund të muajit nëntor 2016 ka përfunduar procesi i ristrukturimit të institucionit në zbatim të strukturës së sipërcituar, ku nga Komisioni i Ristrukturimit janë bërë propozimet përkatëse për

sistemimin e nëpunësve të administratës tatimore në pozicione të caktuara, referuar strukturës së re dhe në përputhje me plotësimin e kriterëve të veçanta të përcaktuara në përshkrimet e punës për çdo pozicion.

Procedurat ligjore për rekrutimin e nëpunësve civilë në pozicionet e krijuara të lira janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe çdo akt-emërimi i nëpunësve civilë në kategoritë përkatëse (ekzekutive, të ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese) hartohet dhe miratohet nga Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse që përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e politikave shtetërore në shërbimin civil dhe zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën e shkurt-prill 2017, në zbatim të akteve të emërimit nga DAP, janë emëruar 10 nëpunës civil.

Deri aktualisht, rezultojnë afërsisht 165 vende vakante, krijimi i të cilave ka ardhur si rezultat i fakteve të ndryshme ligjore, konkretisht, nga ristrukturimi, lëvizje të personelit (emërimet në pozicione të tjera pune nëpërmjet lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, lirimet nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, daljes në pension apo rasteve të tjera të parashikuara në ligj, largim nga shërbimi civil etj).

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, me krijimin e një pozicioni pune të lirë, bën hedhjen e tij në sistemin elektronik të DAP (HRMIS), në mënyrë që njësia përgjegjëse të vijojë me shpalljen dhe menaxhimin e procesit të plotësimit të vendit vakant.

Lidhur me punonjësit administrativë, emërimi i tyre në pozicionet e punës sipas strukturës organizative bëhet në zbatim të dispozitave të Kodit të Punës, si dhe akteve nënligjore, dalë në zbatim të tij, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së punës, si një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit (DPT), nëpërmjet së cilës rregullohen marrëdhëniet e punës dhe përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Për periudhën shkurt-prill 2017, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka lidhur kontrata pune individuale me 62 punëmarrës të rinj.

Në mbështetje të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 7, datë 11.01.2017 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2017 në njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, i ndryshuar, pika 6, si dhe VKM nr. 717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të Institucioneve Buxhetore dhe të nëpunësve të disa Institucioneve Buxhetore”, i ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miratoi detajimin e shpërndarjes së punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2017 në Administratën Tatimore, bazuar në nevojat e argumentuara nga çdo Drejtori Rajonale.

Për aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë miratuar gjithsej 500 vende për punonjës shërbimi, me një kohëzgjatje pune 8 orë/ditë për një periudhë 6-mujore dhe 16 vende për punonjës me kohë të pjesshme (4 orë/ditë vjetore), ku përfshihen, protokollist-arkivist, punonjës pastrimi, punonjës mirëmbajtjeje etj.

Punësimi i punonjësve të shërbimit është në vazhden e një projekti të zbatuar edhe gjatë vitit 2016, për vijimësinë e nismës së iniciuar nga Këshilli i Ministrave, për luftën pa kompromis kundër informalitetit fiskal në shkallë vendi dhe rolit thelbësor të administratës tatimore në këtë proces.

Aktualisht, nga më shumë se 600 aplikime të paraqitura pranë DPT dhe/ose Drejtorive Rajonale Tatimore, janë emëruar 485 punonjës shërbimi me një kohëzgjatje pune 8 orë/ditë për një periudhë 6-mujore, si dhe 15 punonjës me kohë të pjesshme (4 orë/ditë vjetore).

Ju urojmë punë të mbarë.

Me respekt

**ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
XHAVIT ÇURRI**

